

AKT – THEMELIMI
PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BAMLLARI KONSTRUKSION” SHPK

Sot me datë 08.11.2022, z. Roland Bamllari shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1961, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letënjoftimit me nr.032326201 dhe nr. Personal G10916033V, me iniciativën e tij të lirë dhe duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil Shqiptar, dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet "BAMLLARI KONSTRUKSION" Shpk (në vijim referuar edhe si "Shoqëria").

Neni 2
Forma ligjore

“BAMLLARI KONSTRUKSION” Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (në vijim referuar si "Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"), dhe në përputhje me këtë Statut.

Neni 3
Selia

- 3.1 Në momentin e nënshkrimit të këtij Akti Themelimi, selia e Shoqërisë është në Prezë, Tiranë në adresën: Rruga e Prezës, Pasuria me 177/9, Zona Kadastrale 3049.
- 3.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 3.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm, Shoqëria mund të ndryshojë selinë në pikën 3.1, të hapë seli të tjera operative, degë apo zyra përfaqesimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.



Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj sa vijon:

- Projektimi dhe ndërtimi i objekteve civile, industriale, turistike dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë;
- Investimi në projekte zhvillimi me karakter turistik apo rezidencial apo investimi i cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi;
- Shitja ose dhe dhënia me qera e objekteve/njësive të përfituara nga investimet në projekte të zhvillimit të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti;
- Importi-eksporti shitja me shumice e pakice e lendeve te para te ndertimit, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitareve, mobileri, pajisje zyrash, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike, etj;
- Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie ekonomike apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhë kohore te pakufizuar.

Neni 6 Ortaku i Vetëm

6.1 Ortaku i Vetëm themelues i Shoqërisë është:

- **Z. Roland Bamllari**, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1961, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letënjoftimit me nr.032326201 dhe nr. personal G10916033V, **zotërues i 1 (një) kuote**, me vlerë ALL 35,788,297 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) që përfaqëson **100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë**.

6.2 Ortaku i Vetëm përgjigjet për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulon personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i Ortakut të Vetëm/Ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Ortakët gëzojnë kuotat e tyre në Shoqëri në përpjesëtim me kontributin e tyre në kapital.



Neni 7
Kapitali - Kuota

- 7.1 **Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën ALL 35,788,297 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) dhe përfaqëson vlerën në para të kontributit në natyrë (pasuri e paluajtshme e llojit tokë Are, me Nr. Pasurie 177/9, Zona Kadastrale 3049, me sipërfaqe totale 17,150 m², e ndodhur në Prezë, Tiranë, me vlerë EUR 306,066 (treqind e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë euro) nga Ortaku i Vetëm, konvertuar në Lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 08.11.2022 (1 EUR = 116.93 ALL).**
- 7.2 Kuota është e transferueshme në cdo kohë dhe mund të transferohet në përputhje me kushtet e parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me parashikimet në Statutin e Shoqërisë.

Neni 8
Administrimi i Shoqërisë

- 8.1 Shoqëria do të administrohet nga Administratori i parë i vetëm i Shoqërisë:
- **Z. Roland Bamllari**, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1961, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letënjoftimit me nr.032326201 dhe nr. personal G10916033V,
- i cili do të ketë këtë detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 8.2 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) mund të shkarkojë Administratorin/ët në çdo kohë me shumicë të thjeshtë të votave pjesëmarrëse në votim nëse plotësohet kuorumi i vendosur në këtë statut.

Neni 9
Kompetencat e Administratorit

- 9.1 Veprimtaria tregtare e Shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat drejtuese të Shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në si më poshtë vijon, me përjashtim të kompetencave që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara nga neni 81 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare:
- a) zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) sigurimin e përpunueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
 - c) kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
 - d) mirëmbajtjen e rregullt të librave kontabël dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë;
 - e) përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;



- f) kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
- g) thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme kur e vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
- h) përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit përmbledhës të Shoqërisë, raportin për ecurinë e Shoqërisë dhe ta paraqesë atë për miratim tek Asambleja e Përgjithshme, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;"
- i) të punesojë ose të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të biznesit të Shoqërisë;
- j) kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligjin në fuqi si dhe në këtë Statut;

Neni 10 Audituesi Ligjor

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm), kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë, do t'i besohet një ose më shumë Audituesve Ligjorë.

Neni 11 Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare

- 11.1 Viti ushtrimor i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 11.2 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe i Audituesit Ligjor, nëse ka një të tillë, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Ligjin Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare.
- 11.3 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

Neni 12 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ose më shumë likuidatorë, dhe përcaktojë tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 12.3 Me marrjen e vendimit për prishjen dhe likuidimin, Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevojat e likuidimit deri në përfundim të këtij procesi.



4


Neni 13
Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 14
Dispozita të Përgjithshme

- 14.1 Ky Akt për Themelimin e Shoqërisë ka si pjesë të saj edhe Statutin e Shoqërisë i cili bashkëlidhet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Përsa nuk parashikohet në këtë Akt themelimi, funksioni, rregullimi dhe organizimi i shoqërisë rregullohet sipas statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Në rast të likuidimit përfundimtar të Shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi, pushon së vepruari edhe ky Akt Themelimi.
- 14.3 Ky Akt Themelimi perpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, me vlerë të njejtë ligjore, në gjuhën shqipe, dhe nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnet të lirë e të plotë.
- 14.4 Ortaku i Vetëm/Administratori i Shoqërisë do të regjistrojnë këtë Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe do të ndjekin të gjitha hapat e nevojshëm për regjistrimin e Shoqërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Ortaku i Vetëm Themelues i Shoqërisë “BAMLLARI KONSTRUKSION” Shpk
z. Roland Bamllari


Tiranë, datë 08.11.2022